

LIGJ
Nr.10 208, datë 23.12.2009

**PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.8053, DATË 21.12.1995 “PËR KALIMIN NË
PRONËSI, PA SHPËRBLIM, TË TOKËS BUJQËSORE”**

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr. 8053 datë 21.12.1995 “Për kalimin në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore”, pas nenit 3 shtohen nenet 3/1, 3/2 dhe 3/3 si më poshtë:

“Neni 3/1

1. Përdoruesit e tokave bujqësore brenda vijave kufizuese të qyteteve, fshatrave ose qendrave urbane, që disponojnë aktet e marrjes së tokës në përdorim, të lëshuara deri në fund të muajit shkurt të vitit 1996, kompensohen me truall në pronësi brenda zonës urbane përkatëse në çastin që toka e tyre do të kalojë për kompensim fizik të subjekteve të shpronësuara ose për ndërtime publike.

Kompensimi në truall bëhet si më poshtë:

a) për familjet me dhe mbi 6 pjesëtarë, sipërfaqja e truallit është 750m²;

b) për familjet me më pak pjesëtarë zbritet 150 m² për çdo pjesëtar më pak, në përputhje me të dhënat e regjistrit të gjendjes civile të datës 31.12.1995, por jo më pak se 300 m².

2. Përdoruesit e tokës bujqësore brenda vijave kufizuese të zonës me përparësi turizmin, të përcaktuara sipas vendimit nr. 88, datë 1.3.1993 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e zonave që kanë përparësi zhvillimin e turizmit”, që disponojnë aktet e marrjes së tokës në përdorim, të lëshuara deri në fund të muajit shkurt të vitit 1996, kompesohen me truall në pronësi brenda zonës turistike përkatëse, në çastin që toka e tyre do të kalojë për kompensim fizik të subjekteve të shpronësuara ose për ndërtime publike.

Kompensimi në truall bëhet si më poshtë:

a) për familjet me dhe mbi 6 pjesëtarë sipërfaqja e truallit është 750m²;

b) për familjet me më pak pjesëtarë zbritet 150 m² për çdo pjesëtar më pak, në përputhje me të dhënat e regjistrit të gjendjes civile të datës 31.12.1995, por jo më pak se 300 m².

Neni 3/2

1. Kompensimi me truall në pronësi në komunën e Ksamilit bëhet në masën e përcaktuar në nenin 3/1 të këtij ligji dhe vetëm për familjet bujqësore e për individët:

a) që figurojnë punonjës të ish-NB Ksamil në periudhën 1.8.1991 deri 1.10.1992;

b) që kanë ardhur në ish-NB Ksamil nga 1.8.1991 deri në 4.5.1994, subjekte të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 60, datë 21.2.1994 “Për dhënie toke në përdorim familjeve fshatare, banorë të ish-NB-së së Ksamilit”, të ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 185, datë 4.5.1994, të cilat plotësojnë kushtet e pikës 2 të këtij vendimi dhe që në kohën e hyrjes në

fuqi të këtij ligji figurojnë banorë në gjendjen civile të Ksamilit.

2. Subjektet e përfshira në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij neni duhet të provojnë se nuk kanë përfituar tokë në pronësi nga ligji nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”. Subjekteve të pikës 1 të këtij neni, nga sipërfaqja e kompensimit, sipas koeficienteve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, u zbriten sipërfaqet e shesheve të ndërtimit, të fituara me vendime të komunës deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Neni 3/3

1. Trojet e vëna në dispozicion për kompensim për përdoruesit e tokës bujqësore, sipas këtij ligji, përcaktohen:

a) në zonat turistike bregdetare, nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore në territorin ku ndodhet trualli që kalon për kompensim;

b) në zonat periferike të qyteteve dhe qendrave urbane, nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore në territorin ku ndodhet trualli që kalon për kompensim, pas përfundimit të procesit të legalizimit nga ALUIZNI.

2. Sipërfaqet e tokës në përdorim që lirohen nga përdoruesit, si pasojë e zbatimit të dispozitave të këtij ligji, kalohen:

a) në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si fond fizik për kompensimin e subjekteve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.868, datë 18.6.2008 “Për krijimin e fondit të kompensimit fizik nga fond i tokës bujqësore”, kur këto sipërfaqe, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, figurojnë në zërin kadastral tokë bujqësore;

b) në pronësi të shtetit dhe administrohen sipas kompetencave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për urbanistikën, kur këto sipërfaqe, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, figurojnë në zërin kadastral tokë urbane.

3. Procedurat dhe autoriteti publik që bën kalimin në pronësi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6384, datë 13.1.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**